

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit R.M., nga fsh. K., komuna e Sh., për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.183/2016 datë 03.05.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.450/2017 datë 09.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 02.07.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit R.M., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.183/2016 datë 03.05.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.450/2017 datë 09.10.2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj -Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.183/2016 e datës 03.05.2017, të dënuarin R.M. e ka shpallur fajtor për veprën penale lëndim i rëndë trupor, nga neni 189 par.4 të KPRK-së, dhe për këtë vepër penale e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) viteve, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 05.08.2017 deri sa aktgjykimi të bëhet i ekzekutueshëm përkatësisht deri sa të filloj ekzekutimi i vuajtjes së dënimit të shqiptuar me burg. I dënuari është obliguar që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale 40 €, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.450/2017 e datës 09.10.2017, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit kurse aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. T.Rr., nga Prishtina, për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni 385 par.1.4 të KPRK-së, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 të KPPK dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1 nënpar.3 lidhur me nenin 384 par.2 nënpar.1 dhe 2 të KPPK, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimet e kundërshtuara ti ndryshojë të dënuarin ta lirojë nga akuza, ta ndryshojë aktgjykimin sa i përket cilësimit juridik të veprës penale, ashtu që të dënuarin ta shpall fajtor për vepër penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 të KPRK ose aktgjykimet t'i anuloi dhe çështja ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit, me parashtrësën KMLP.nr.69/2018 e datës 13.04.2018, me propozim që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat të çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë pretendohet se aktgjykimet ai i shkallës së parë dhe i shkallës së dytë janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPPK, sepse dispozitivi është i pakuptueshëm, kundërthënës me brendinë e tij dhe se në të nuk janë paraqitur arsyet mbi faktet vendimtare, ndërsa disa nga arsyet e paraqitura në masë të konsiderueshme janë në kontradiktë në mes të asaj çka paraqitet në arsyet e aktgjykimit dhe përmbajtjes së provave, derisa në dispozitivin e aktgjykimit thuhet se i pandehuri më parë kishte pasur një mosmarrëveshje me të ndjerin, në dispozitiv të aktgjykimit nuk thuhet se kur i pandehuri dhe i ndjeri kanë pasur mosmarrëveshje dhe as për çfarë mosmarrëveshje bëhet fjalë që e bënë dispozitivin e aktgjykimit të paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të dënuarit se aktgjykimet janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal janë të pabazuara.

Siç rezulton nga shkresat e çështjes, aktgjykimi i shkallës së parë i vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së dytë, është i qartë dhe konkret, ngase në dispozitiv janë paraqitur të gjitha veprimet inkriminuese të dënuarit që përbëjnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor. Gjykata ka

dhënë arsye të mjaftueshme për fakte vendimtare duke vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e vendosjes së kësaj çështje penale-juridike, e sidomos me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim e me dispozitat e nenit 361 par.2 kurse, për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par.7 të KPPK, duke paraqitur në mënyrë të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose si të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale, e që nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i kundërshtuar del se me administrimin e provave në shqyrtimin gjyqësor, deklaratat e dëshmitarëve H.K., V.M., G.P., raporti i autopsisë për të ndjerin i datës 17.10.2016, është vërtetuar se i dënuari R.M. me datën 05.08.2016, rreth orës 11.30 min., në fshatin K., komuna e F., për shkak të një mosmarrëveshje të mëparshme me dashje i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të cilat kanë rezultuar me pasoja vdekjeprurëse për tani të ndjerin R.C., duke e goditur me lopatë në kokë, në krahun e majtë si dhe në këmbën e majtë e për shkak të këtyre lëndimeve i njëjti ka vdekur me datë 16.10.2016 në QKUK në Prishtinë.

Përkitazi me shkeljet e ligjit penal, në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit pretendohet se vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykatës së Apelit, se në veprimet e të dënuarit manifestohen elementet qenësore që përbëjnë figurën e veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.4 të KPRK, është i gabuar, mbrojtja nuk pajtohet me kualifikimin ligjor të veprës penale të ricilësuar nga gjykata e shkallës së parë, që paraqet formën cilësuese të kësaj vepre penale, sepse siç del nga shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se ekziston lidhja shkakore (kauzale) në mes të veprimit dhe pasojës, pra në mes të goditjes së të ndjerit nga ana e të dënuarit dhe vdekjes së të ndjerit.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton, se gjykata e shkallës së parë ,përkitazi me faktet kontestuese, në këtë çështje penale juridike, përveç deklaratave të dëshmitarëve H.K., G.P. dhe V.M., të cilët gjatë dëshmisë së tyre në shqyrtimin gjyqësor secili nga këndi i vet e kanë përshkruar në mënyrë kronologjike rastin e ndodhur me datën 05.08.2016, ku i ndjeri nga lëndimet e marra ka ndërruar jetë në QKUK në Prishtinë, me datën 16.10.2016, këtë e ka vërtetuar edhe nga raporti i autopsisë.

Nga raporti i autopsisë MA 16-26 të datës 17.10.2016, për të ndjerin R.C., të kryer nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, është konstatuar se vdekja e të ndjerit R.C., është me dhunë dhe ka ardh si pasojë e dërmimit të trurit e shoqëruar me thyerje të shumëfishta të kockave të kafkës, e përcjellur me dështim multifunksional të të gjitha organeve, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë, i topitur), andaj, kjo gjykatë vlerëson se nuk janë të bazuara pretendimet në kërkesën e

mbrojtësit të dënuarit se vdekja e tani të ndjerit R.C., nuk është pasojë e goditjes me lopatë dhe lëndimet e shkaktuara nga këto goditje, ngase këto pretendime janë në kundërshtim me konstatimin e dhënë në raportin e autopsisë.

Andaj, bazuar në konstatimin e autopsisë të datës 17.10.2016, është konstatuar se vdekja e të ndjerit ka ardhur si rezultat i goditjes me mjet të fort, edhe pse nga lëndimet e shkaktuara i dëmtuari tani i ndjeri është kuruar-trajtuar në qendrën spitalore për më tepër se dy muaj, ndërsa nuk është paraqitur ndonjë rrethanë relevante që do të tregojë se vdekja nuk është pasojë e lëndimit të pësuar.

Gjykata Supreme vlerëson se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, ndërsa pretendimi i mbrojtësit se me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit nuk janë të bazuara, ngase dispozita e nenit 189 par.4 e KPRK-së, parasheh që “ Kushdo që i shkakton lëndim të rëndë trupor personit tjetër ose e dëmton shëndetin e personit tjetër deri në masën e tillë sa që mund të rezultojë me vdekjen e personit tjetër”. Pra, në rastin konkret Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe shkallës së dytë drejtë kanë aplikuar ligjin penal kur kanë bërë rikualifikimin nga vepra penale e vrasjes nga neni 178 të KPRK në veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.4 të KPRK.

Nga arsyet e dhëna më sipër kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 437 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Pml.nr.94/2018, më datë 02.07.2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa